



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

RREGULLORE

MBI

**LIKUIDIMIN E DETYRUESHËM TË DEGËS SË SHOQËRISË SË SIGURIMIT,
TË NJË VENDI TË HUAJ DHE NJË VENDI ANËTAR TË BE-SË**

Miraturar me Vendimin e Bordit nr. 54, datë 26.05.2017

Neni 1

Objekti

Kjo rregullore përcakton rregullat e likuidimit të detyrueshëm të degës së shoqërisë së sigurimit, të një vendi të huaj dhe degës së shoqërisë së sigurimit të një vendi anëtar të BE-së.

Neni 2

Fusha e zbatimit

Kjo rregullore zbatohet nga të gjitha degët e shoqërive të sigurimit të huaja dhe të vendeve anëtare të BE-së, të licencuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare për të ushtruar veprimtari sigurimi dhe risigurimi në klasat e Jetës dhe Jo-Jetës, në Republikën e Shqipërisë.

Neni 3

Baza ligjore

Kjo rregullore hartohet në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 2, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, si dhe të nenit 175, pika 3, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”.

Neni 4
Dispozita të përgjithshme

1. Përkufizimet dhe terminologjia e përdorur në Ligjin nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, zbatohen edhe për këtë rregullore.
2. Të gjitha dispozitat e Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” dhe të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, që zbatohen për likuidimin e detyrueshëm të shoqërive të sigurimit zbatohen rast pas rasti edhe për degën e shoqërisë së sigurimit të vendit të huaj dhe të vendit anëtar të BE-së.

Neni 5

Hapja e procedurave të likuidimit të detyrueshëm për degën e shoqërisë së sigurimit të vendit të huaj

1. Hapja e procedurave të likuidimit të detyrueshëm të degës së shoqërisë së sigurimit të vendit të huaj bëhet vetëm pas marrjes së vendimit të Autoritetit sipas parashikimeve të nenit 175, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”.
2. Përveç rasteve të përmendura në nenin 175, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, hapja e procedurave të likuidimit të detyrueshëm të degës së shoqërisë së sigurimit të vendit të huaj, mund të bëhet edhe pas marrjes së vendimit të autoritetit apo gjykatës kompetente të vendit të huaj, për hapjen e procedurave të likuidimit të detyrueshëm të shoqërisë së sigurimit të themeluar në këtë vend të huaj apo edhe të degëve të saj.
3. Pas marrjes së vendimit sipas pikës 1, të këtij neni, dega e shoqërisë së sigurimit të vendit të huaj, regjistron në mënyrën e duhur dhe sipas legjislacionit shqiptar, të gjitha pretendimet e ngritura në lidhje me kontratat e sigurimit.

Neni 6

Raportimi i likuidatorit

1. Likuidatori i emëruar nga Autoriteti për degën e shoqërisë së sigurimit të vendit të huaj, sipas nenit 176, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, raporton në Autoritet një herë në muaj në lidhje me procesin e likuidimit.
2. Raportimi i likuidatorit sipas pikës 1, të këtij neni, paraqitet në Autoritet, në datën 10 të muajit pasardhës për periudhën e muajit paraardhës. Raportimi final i likuidatorit paraqitet në Autoritet 15 ditë pune pas finalizimit të procesit të likuidimit.
3. Likuidatori raporton gjithashtu çdo të dhënë apo informacion që mund të kërkohej nga Autoriteti.

Neni 7

Njoftimi për hapjen e procedurave të likuidimit të detyrueshëm

1. Autoriteti para miratimit të vendimit për likuidimin e detyrueshëm të degës së shoqërisë së sigurimit të vendit të huaj njofton autoritetin kompetent mbikëqyrës të vendit të huaj dhe shoqërinë e sigurimit të vendit të huaj, dega e të cilit është subjekt i procedurave të likuidimit në Shqipëri.
2. Përjashtimisht nga sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, në rastet kur për shkak të ruajtjes së interesave të të sigurve nuk është i mundur njoftimi paraprak për hapjen e procedurave të likuidimit të detyrueshëm, Autoriteti njofton autoritetin kompetent mbikëqyrës të vendit të huaj dhe shoqërinë e sigurimit të vendit të huaj, brenda 7 ditëve kalendarike pas marrjes së vendimit për hapjen e procedurave të likuidimit të detyruar të degës e cila është subjekt i procedurave të likuidimit të detyrueshëm në Republikën e Shqipërisë.

Neni 8

Bashkëpunimi me autoritetin kompetent të vendit të huaj

Autoriteti gjatë procedurave të likuidimit të detyrueshëm të degës së shoqërisë së sigurimit të vendit të huaj bashkëpunon ngushtë me autoritetin kompetent mbikëqyrës të vendit të huaj ku

është e themeluar shoqëria e sigurimit, ndaj degës të së cilës janë hapur procedurat e likuidimit të detyrueshëm në Republikën e Shqipërisë, për të gjitha çështjet që lidhen me procesin e likuidimit.

Neni 9

Likuidimi i detyrueshëm për degën e shoqërisë së sigurimit të vendit anëtar i BE-së

Dispozitat e mësipërme në lidhje me likuidimin e detyrueshëm për degën e shoqërisë së sigurimit të vendit të huaj, zbatohen edhe për degën e shoqërisë së sigurimit të vendit anëtar i BE-së.

Neni 10*

Publikimi për hapjen e likuidimit të detyrueshëm për degën e shoqërisë së sigurimit të vendit anëtar i BE-së

1. Vendimi i hapjes së procedurave të likuidimit të detyrueshëm për degën e shoqërisë së sigurimit të vendit anëtar, publikohet në “Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian”.
2. Së bashku me vendimin e hapjes së procedurave të likuidimit të detyrueshëm për degën e shoqërisë së sigurimit të vendit anëtar i BE-së, sipas pikës 1 të këtij neni, publikohet autoriteti kompetent, emri dhe adresa e likuidatorit të emëruar, si dhe ligji i zbatueshëm në lidhje me procedurat e likuidimit.

Neni 11

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi menjëherë.

* Në përputhje me nenin 262, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, neni 10 i kësaj rregulloreje është i pazbatueshëm deri në datën e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian.